



PANTALLONA **KUQI**

A.R.GREEN

Titulli i origjinalit:
The Man in the Red Underpants

Autor:
A.R Green

Përktheu:
Kushtrim Berisha

Redaktor gjuhësor:
Jeton Koqinaj

Redaktor profesional:
Jusuf Kastrati

Kopertina:
Fatlum Zeka

Botoi:
Instituti Germa

© Instituti Germa
Të gjitha të drejtat e këtij libri janë të rezervuara.
Ndalohej kopjimi dhe riprodhimi i pjesëshëm ose i
plotë në çfarëdo forme pa lejen e botuesit.

A.R. Green

Pantallonakuqi

PANTALLONAKUQI

Kapitulli 1

UDHËTIMI FILLON

Jam i sigurt se nuk do të të pëlqejë ky libër. Mbase as një grimë. Ky libër flet për një mori gjërash që shumë prej nesh orvatemi fort t'i shmangim, siç është vdekja! Po pra, vdekja. Vdekja, gjykimi, Ferri dhe Parajsa (në mos qofshin tërë këto veç fjalë në erë), kuptimi i jetës dhe natyrisht, dilema e madhe - a ka vërtet Zot, apo tërë kjo është një mashtrim. Pra, pikërisht ato gjëra të cilat përpiqesh vazhdimisht t'i mbash larg mendjes. Atëherë, ç'lidhje ka kjo me burrin me pantallonat e kuqe?

Kam dëshirë që ti të më bashkëngjitësh në një udhëtim. Nuk është i gjatë, por gjatë rrugës do të hasim në disa gjëra shumë

interesante, ndoshta edhe të frikshme, gjëra që mbase nuk dëshiron t'i besosh, edhe nëse kanë kuptim. Disa këtu zmbarsen të frikësuar, disa lënë këtë libër dhe kurrë nuk e përfundojnë, disa të tjerë ngrenë hundët me neveri, gjë që është jashtëzakonisht fatkeqe, se kështu ti humb gjënë më të rëndësishme në jetë!

Disa e lexojnë tërë librin, ndoshta edhe pajtohen me të, por kurrë nuk do të arrijnë të bëjnë diç në lidhje me të, gjë e cila sa është pikëlluese, aq është për keqardhje. E po, të thashë që këtu do të ketë gjëra që nuk do të të pëlqejnë! Megjithatë, ka të atillë që do t'i shkojnë kësaj çështjeje deri në fund. Do të mendosh pak, mbase shumë, dhe pastaj do të bësh diçka vërtet mahnitëse me jetën tënde: do të pranosh përfundimet e pashmangshme të arsyes, do të marrësh

frymë thellë (të paktën mendërisht) dhe do të bësh një zotim që do të të transformojë në mënyrë të mrekullueshme. Sado e frikshme të të duket, pasi ta kesh bërë këtë, gjërat do të kenë kuptim edhe më tepër.

Mirë, mjaft me emocione tash, të futemi në thelb të çështjes. Le të fillojmë udhëtimin e të hipim në automjetin tonë të arsyes dhe sensit të përbashkët (mendimit praktik).

Çka do të bëje nëse një burrë me pantallona të kuqe do të trokiste në derën tënde dhe të të thoshte se ka ardhur për kontrolluar ujëmatësin?

Po po, seriozisht e kam, çfarë do të bëje? Ç'është e vërteta, nuk ka shumë rëndësi çka do të bëje. Më me rëndësi janë procesi dhe aftësitë që do t'i përdorje për të formuar një mendim për këtë njeri dhe pretendimin e

tij. A do t'i besojë ashtu pa menduar dhe ta lejojë në shtëpi? A do t'i besojë "verbërisht"? Apo do të mendojë për këtë situatë, të bëjë disa pyetje dhe të vendosjë arsyen në funksion? Jam i sigurt se do ta bëjë të dytën. Edhe nëse do t'i thoshe: "Shporru që këtej, çmeritës!", prapë do të përdorje arsyen, logjikën dhe sensin e përbashkët për ta kuptuar burrin me pantallonat e kuqe, mu ashtu siç veprojmë me shumicën e gjërave në jetë.

Tash, para se të vazhdojmë tutje, duhet të pajtohesh me mua për një gjë, përndryshe s'ka kuptim të shkojmë më tutje. Duhet të pajtohesh se bota në të cilën jetojmë është e vërtetë dhe unë e ti, si dhe gjithçka që na rrethon, vërtetë ekziston dhe nuk është produkt i ndonjë bote iluzionare të gjeneruar me kompjuter, ose produkt i një

ëndrre. Tash, shtrohet pyetja: çka na hyn në punë kjo? Nëse mendojmë se gjithçka që dimë është iluzion, atëherë asgjë më s'ka kuptim. Madje, edhe nëse do të pranohim një gjë të tillë, prapë do të përdornim arsyen për t'u dhënë kuptim gjërave dhe në fund, pashmangshëm do të pranohim se çdo gjë që shohim është disi e vërtetë.

Nëse pajtohesh me mua se bota është e vërtetë dhe se çfarëdo që shohim, nuhasim, prekim, dëgjojmë dhe shijojmë po ashtu është e vërtetë dhe se shqisat tona i dërgojnë informata trurit dhe ne e përdorim mendjen për t'i kuptuar gjërat, atëherë ta përdorim të njëjtin proces të arsyesimit për të kuptuar jetën, botën, universin dhe gjithçka tjetër. Tash, kemi disa ide të cilat i quajmë “universalitete”, sepse gati shumica e njerëzve i pranojnë ato. Në fakt, këto ide

janë aq themelore, saqë janë pjesë e natyrës njerëzore dhe, nëse dikush nuk do t'i pranonte, do të mendonim se ka luajtur mendsh.

Për shembull, deklarata "një pjesë e diçkaje është më e vogël se e tëra" është ide universale. Është e përbashkët te të gjithë njerëzit, prandaj e quajmë sens të përbashkët. Është kaq e qartë sa nuk ka nevojë për shpjegim. Pajtohesh deri këtu? Mirë. Ja një tjetër: "Diç nuk vjen prej hiçit." Po ashtu: "Rendi nuk lind vetvetiu nga kaosi."

A ka diçka nga tërë përvojat tona njerëzore që na shtyn të besojmë se diçka mund të vijë prej hiçit ose se rendi lind ashtu vetvetiu nga kaosi?

Po pra! Asgjë. Në fakt, ne vazhdimisht shohim rregull, formë dhe sistem. Diçka ka imponuar këtë rregull, këtë formë dhe këtë sistem. Sa më komplekse dhe sa më të rregullta të jenë sistemet dhe sa më funksionale të jetë forma, aq më i lartë është niveli i inteligjencës pas saj.

Ja dy të vërteta që mund t'i përdorim për t'i dhënë kuptim botës: universi dhe jeta. Përvoja universale njerëzore na tregon se, kur gjejmë gjërat që funksionojnë sipas sistemeve, ligjeve dhe modeleve, ka diçka që i ka bërë ato sisteme, ligje dhe modele. Mu për këtë arsye ndodh që një arkeolog të gjejë një copë qeramike në tokë dhe të nxjerrë përfundimin me siguri dhe me bindje se disa njerëz, të cilët nuk i ka parë kurrë, e kanë bërë këtë copë qeramike. Ç'është e vërteta, ai mund të jetë në gjendje

të na tregojë një sërë gjërash për ata njerëz, kulturën dhe nivelin e teknologjisë së tyre vetëm nga kjo pjesë e qeramikës. Ai e di se ajo është e dizajnuar, e nuk është produkt i disa lëvizjeve të rastësishme të Tokës, Diellit dhe zjarrit natyror të pyjeve që disi u bashkuan për të prodhuar atë copë qeramike. Ndoshta mund të ketë ndodhur kështu, megjithatë është e largmendshme. Në fakt, sa më shumë që arkeologu e vështron atë qeramikë, aq më e pamundur duket që ajo të jetë krijuar vetvetiu dhe aq më i sigurt është ai që ajo qeramikë është dizajnuar me qëllim (po qe se ka pasur ndonjë dyshim në radhë të parë!).

Le të marrim shembull diçka tjetër që ne shumica e kemi dhe e përdorim rregullisht: telefonin. Telefoni yt përbëhet prej disa elementesh bazë: plastikës, xhamit, silikonit

për çipin dhe disa metalesh të çmuara. Plastika vjen prej vajit, ndërsa qelqi dhe silikoni prej rërës. Thënë shkurt, ti mban në dorë vaj dhe rërë.

Po sikur të të thosha se një ditë, teksa po ecja nëpër Shkretëtirën e Arabisë (ku ka shumë vaj dhe rërë), hasa një telefon, i cili kishte qenë produkt i ngjarjeve të rastësishme miliarda vjeçare, kishte fryrë era, kishte shkëlqyer dielli, kishte rënë shi, kishte goditur rrufeja, kishte valuar vaji, kishte kaluar deveja dhe pas miliona e miliona vitesh, telefoni ishte formuar vetë. Rrjedhimisht, unë e mora këtë telefon, e shtypa butonin e thirrjes dhe bëra një telefonatë.

A ka ndonjë mundësi që ai të jetë formuar përmes proceseve të rastësishme natyrore? Sado që të jetë e mundur, shumica prej nesh

thjesht nuk do ta pranonin këtë si shpjegim të arsyeshëm.

Pse, atëherë, të pranojmë një shpjegim të tillë për origjinën e universit tonë dhe jetën brenda tij? Edhe nëse e pranojmë evolucionin si proces, ideja se jeta ka evoluar thjesht si një seri ngjarjesh të rastësishme është e vështirë të pranohet si shpjegim i arsyeshëm. Edhe qeliza më themelore e njeriut është shumë më e ndërlikuar sesa një telefon! Teoria e evolucionit së paku përpiqet të ofrojë një shpjegim se si mund të ketë ndodhur kjo, ama ideja se universi është produkt i disa ngjarjeve të rastësishme ua kalon të gjithave. Po ashtu ligjet, sistemet dhe format që përbëjnë universin janë në fakt shumë më komplekse se ato që rregullojnë jetën biologjike!

Le të marrim shembullin e tokës dhe sistemit tonë diellor. Toka rrotullohet rreth boshtit të saj një herë në njëzet e katër orë. Përfytyroni sikur toka njëherë të rrotullohej shumë ngadalë dhe një ditë ose natë të zgjaste, le të themi, 30 ose 40 vjet në vend të 24 orëve. Gjatë kësaj kohe, një pjesë e sipërfaqes së tokës do të ekspozohej ndaj dritës së diellit, ndërsa tjetra do të mbetej në errësirë. Pra, një pjesë e sipërfaqes së tokës do të ishte tejet e nxehtë dhe tjetra tejet e ftohtë. Ose, nëse do të ishim për një fije më afër ose më larg Diellit (në terma kozmologjikë), do të ishte shumë nxehtë ose shumë ftohtë. Ose, nëse përbërja e gazeve në atmosferë nuk do të kishte saktësisht përzierjen e duhur të oksigjenit, dioksidit të karbonit dhe azotit, ose nëse nuk do të kishte ozon për të filtruar efektet

e dëmshme të rrezatimit të diellit, është e vështirë të thuhet se jeta do të ekzistonte (pa këto kushte optimale).

Kur shikojmë teorinë e Big Bengut që shpjegon origjinën e universit, mund të pyesim me të drejtë: Që kur shpërthimet formuakan sisteme të ndërlikuara e të balancuara dhe forma komplekse jete? Megjithatë, disa sugjerojnë se kjo ka ndodhur me universin dhe Big Bengun! Dikush mund të thotë se kjo është një qasje tejet e thjeshtësuar, por ja që edhe shkencë sugjeron që ligjet që qeverisin universin janë aq hollësisht të rregulluara, sa që jeta nuk do të mund të ekzistonte pa këtë shkallë të lartë rregulli.

Kjo mund të vërehet në ato që quhen konstante të natyrës, nga të cilat ka mjaft. Megjithatë, le të përqendrohemi në katër

nga forcat më të njohura: forca e fortë bërthamore, forca e dobët bërthamore, forca elektromagnetike dhe graviteti. Dy prej tyre: forcat elektromagnetike të forta dhe të dobëta, janë përgjegjëse për prodhimin e karbonit, elementi mbi të cilin bazohet gjithë jeta. Forcat bashkëpunojnë në atë mënyrë që të krijojnë një ekuilibër të niveleve të energjisë, i cili mundëson prodhimin e karbonit nga shkrirja e tri atomeve të heliumit. Ka shumë pak gjasa që tri atome të heliumit të përplasen dhe të krijojnë karbon në rrethana normale, pasi energjitë nuk do të përputheshin dhe tri atomet e heliumit do të ndaheshin përpara se të kishin kohë për t'u shkrirë në karbon. Mirëpo, nëse ka një përputhje statistikisht të pazakontë të energjive, atëherë procesi është shumë më i shpejtë. Ndryshimi më i

vogël në forcat e forta ose të dobëta elektromagnetike do të ndryshonte nivelet e energjisë, duke rezultuar në një reduktim të madh të prodhimit të karbonit dhe në një univers përfundimisht të pabanueshëm.

Konsideroni gjithashtu forcën e gravitetit. Pas Big Bengut, miliarda vite më parë, materia në univers u shpërnda rastësisht. Nuk kishte planetë, galaktika ose yje, por vetëm atome që vërtiteshin vërdallë nëpër zbrazëtinë e errët të hapësirës, ndërkohë universi filloi të zgjerohej, graviteti filloi t'i tërhiqte atomet lehtëzi gjithnjë e më shumë, duke i mbledhur ato në tufa që përfundimisht u bënë yje dhe galaktika. E rëndësishmja është se forca e gravitetit duhej të ishte tamam ideale që kjo të ndodhte. Nëse forca e gravitetit do të ishte pak më e dobët, atomet do të ishin

shpërndarë aq gjerë, sa nuk do të ishin mbledhur kurrë në galaktika, yje dhe planetë. Nëse forca e gravitetit do të ishte pak më e fortë, atomet do të ishin tërhequr së bashku në një masë të vetme dhe më pas Big Bengu (Shpërthimi i Madh) do të mbetej Big Crunch (Shtypja e Madhe). Forca e gravitetit duhet të jetë ideale që të formohen yjet. Mirë, e çka i bie “tamam ideale” këtu? E po, i bie sikur pesha jote të ishte më e rëndë ose më e lehtë për një të miliardtën e gramit! Pra, për një fije të tillë dallimi universi do të ishte aq ndryshe sa nuk do të kishte galaktika, yje, planetë ose jetë. Kjo e bën humbjen e disa kilogramëve të duket e thjeshtë, apo jo? Është e çuditshme se si njerëzit inteligjentë dhe të arsimuar nuk mund të humbasin pak peshë për të jetuar më gjatë, por universi mund të

vetorganizohet vetvetishëm me kushte optimale për jetën!

Ka ende! Le t'i hedhim një vështrim më të afërt shkallës e zgjerimit të universit pas Big Bengut. Nëse shkalla e zgjerimit do të ishte më e madhe dhe universi i hershëm do të zgjerohej më shpejt, materia në univers do të ishte shpërndarë aq shumë, sa graviteti nuk do ta kishte mbledhur kurrë atë në yje dhe galaktika. Nëse shkalla e zgjerimit do të ishte më e ngadaltë, graviteti do ta kishte mposhtur zgjerimin dhe do ta kishte tërhequr gjithë materien në një vrimë të zezë. Nëse shkalla e zgjerimit, një sekondë pas Big Bengut do të ishte më e ngadaltë, goftë dhe për një të njëqindmijëmiliontën e sekondës, universi do të ishte shembur përpara se të arrinte madhësinë e tij aktuale! Megjithatë, shkalla e zgjerimit ishte

tamam ideale duke mundësuar kështu ekzistencën e yjeve në univers.

Një shembull tjetër i këtij rregullimi të imët është dendësia e universit. Në mënyrë që universi të rritej ashtu që të mbante jetën, ai duhet të ketë ruajtur një dendësi të përgjithshme jashtëzakonisht të përpiktë. Përpikëria e dendësisë duhet të ketë qenë aq e lartë, sa që ndryshimi i një të njëmijepesëmbëdhjetës pjesë (pra, 0.00000000000001%) do të kishte rezultuar në një kolaps ose krisje të madhe, duke ndodhur kështu tepër herët për të mundësuar zhvillimin e jetës, ose do të kishte pasur një zgjerim aq të shpejtë, sa nuk mund të ishte formuar asnjë yll, galaktikë ose jetë.

Të kujtohet telefoni në shkretëtirë?

A nuk është shumë më e arsyeshme të nxirret përfundimi se universi dhe jeta janë rezultat i një dizajni të qëllimshëm inteligjent?

Fundja, çfarë opsionesh të tjera ka?

A mund të ketë ardhur universi prej hiçit? Nëse po, atëherë pse të mos e zbatojmë këtë gjithkund tjetër në jetën e përditshme?

Mbase burri me pantallonat e kuqe është shfaqur ashtu rastësisht ose ndoshta e ka krijuar vetveten! Eh pra, ne nuk ia atribuojmë koleksionit të yjeve dhe galaktikave, përkatësisht universit, aftësinë për të projektuar dhe sistemuar. Sigurisht që kjo gjë ka nevojë për inteligjencë dhe vullnet, apo jo?

Pra, nëse sensi i përbashkët dhe arsyeja udhëzojnë kaq preraz drejt ekzistencës së

një dizajni inteligjent dhe të vullnetshëm, në çfarë përfundimesh të tjera mund të arrijmë nëpërmjet përdorimit të arsyes?

Një përfundim i sigurt që mund të arrihet është se natyra e burimit të kësaj inteligjence dhe vullneti duhet të dallojë nga universi të cilin e krijoi.

Po pse, vallë? Kjo, se, po të ishin këto të dyja e njëjta gjë, atëherë thjesht i bie se kemi edhe një gjë të njëjtë, pra, më shumë krijim dhe kështu me të drejtë mund të pyesim se kush e krijoi këtë të dytën atëherë. Me siguri ishte diçka më inteligjente dhe më e vullnetshme se dy të parat. Pastaj sigurisht që do të bënim të njëjtën pyetje për këtë të tretën: çfarë e krijoi atë? Kështu do të vazhdonim të kërkonim pareshtur inteligjencën dhe vullnetin pas inteligjencës dhe vullnetit, pra një krijues që krijon një

krijues që krijon një krijues... deri në pafundësi! Ka një arsye të mirë pse gjërat nuk mund të jenë kështu, gjë që shpjegohet më së miri përmes një shembulli.

Përfytyroni një snajper që ka marrë në shënjestër viktimën e tij. Tash, ky merr në radiolidhje shtabin për të kërkuar lejen për të qëlluar. Megjithatë, shtabi i thotë snajperit të presë derisa ata kërkojnë leje nga lart. Kështu, personi më lart kërkon leje nga dikush tjetër më lart, e kështu me radhë deri në pafundësi.

Nëse kjo vazhdon kështu, a do të arrijë ndonjëherë snajperi të qëllojë cakun e tij?

Sigurisht që jo!

Ai do të mbetet përjetësisht në pritje të një urdhri nga lart. Duhet të ketë një vend ose

person prej nga lëshohet komanda, një vend ku nuk ka më lart.

Kështu, shembulli ynë ilustron se ka një të metë racionale në idenë se mund të ketë krijues të cilët krijojnë krijues deri në pafundësi. Nuk mund të kemi krijues që krijojnë krijues përgjithmonë, ose përndryshe, ashtu si snajperisti që nuk do të qëllonte kurrë, as krijimi nuk do të krijohej kurrë. Por krijimi është këtu tashmë. Ekziston. Kështu pra, mund ta hedhim poshtë idenë e një regresioni të pafund shkaqesh për shkak se është parashtrim i paarsyeshëm.

Atëherë, çfarë zgjidhjeje tjetër ka?

Zgjidhja është një shkak fillestar. Një shkak i pashkaktuar!

Së këndejmi, mund të arrijmë në përfundimin se natyra e forcës inteligjente dhe të vullnetshme që qëndron prapa krijimit të universit, jetës dhe gjithçkaje tjetër, pa dyshim dallon nga natyra e krijesave dhe, siç e pamë, ka arsye bindëse për të menduar kështu.

Pra, nëse krijesat janë nevojtare, atëherë Krijuesi duhet të jetë i vetëmjaftueshëm. Nëse krijesat janë të përkohshme, Krijuesi duhet të jetë i përjetshëm. E, nëse krijesat janë të kufizuara në hapësirë dhe në kohë, Krijuesi duhet të jetë i lirë nga këto kufizime.

Po ashtu, në qoftë se krijesat janë të zakonshme, Krijuesi duhet të jetë unik. Rrjedhimisht, arsyeja dikton se mund të ekzistojë vetëm një qenie unike, e përjetshme, e vetëmjaftueshme, e pakufizuar në hapësirë dhe në kohë, sepse,

nëse do të kishte më shumë se një, atëherë këto veçori do të ishin të pazbatueshme. Si mund të ketë dy ose tri qenie të përjetshme, ose dy qenie të pakufizuara në hapësirë dhe në kohë?

Për këtë arsye ka shumë kuptim të besosh në Një Krijues të Përjetshëm Unik dhe të Vetëmjaftueshëm.

Sensi i përbashkët dhe arsyeja çojnë lehtësisht, madje pashmangshëm, në përfundimin se universi është krijuar prej një qenieje transcendentë, që në thelb është ndryshe nga çdo gjë që dimë.

Kjo, natyrisht, e bën të vështirë të kuptosh më tepër për këtë Krijues përmes arsyes dhe për këtë arsye disa njerëz ndalojnë pikërisht aty.

Mirëpo, udhëtimi ynë nuk përfundon këtu. Ç'është e vërteta, më e drejtë është të themi se pikërisht fillon këtu. Kemi ende shumë pyetje pa përgjigje dhe shumë çështje të pazgjidhura.

Kapitulli 2

Pse ka vuajtje në botë?

Nëse ka Krijues, pse ky Krijues lejon që të ndodhin gjëra të këqija?

Cili është qëllimi i jetës?

Pse jemi këtu, për çfarë qëllimi dhe ku po shkojmë?

A ka jetë pas vdekjes?

A ka ndonjë mënyrë për të ditur më shumë për këtë Krijues?

Nisur nga ajo se Krijuesi na ka dhuruar mundësinë për të përmbushur çdo nevojë që kemi, si fizike ashtu dhe emocionale, nuk është e habitshme ose e jashtëzakonshme që Ai të na japë ndonjë udhëzim në çështje të tilla. Ne ndiejmë uri dhe kemi nevojë për lëndë ushqyese për të na mbajtur gjallë, por

njëkohësisht i kemi të gjitha mjetet për t'i siguruar ato lëndë ushqyese. Ndiejmë etje dhe pijen e kemi. Kemi nevojë për rroba dhe, njëkohësisht, i kemi mjetet për t'i siguruar ato. Ne gjithashtu kemi nevojë për shoqëri, dashuri dhe mbështetje, andaj kemi prindër e familje dhe jetojmë në shoqëri që përmbushin këto nevoja. Ka kuptim që Ai që na i ka përmbushur të gjitha këto nevoja të na japë gjithashtu përgjigje për çështje të tilla të thella, ngulmuese dhe të rëndësishme.

Në fakt, këto pyetje të thella janë edhe më të rëndësishme se çështjet fizike dhe emocionale, pasi që ato përcaktojnë vetë arsyen e ekzistencës sonë. Provat tregojnë se, kur njerëzit nuk kanë drejtim e qëllim të qartë dhe bindës në jetë si individë dhe shoqëri, ata bëhen thellësisht të pakënaqur,

të hutuar dhe të palumtur. Pra, nevoja për të ditur pse jemi këtu e ku po shkojmë dhe pse ekziston gjithçka është po aq e rëndësishme për ne sa ushqimi, pija dhe intimiteti!

Ka shumë përgjigje të mundshme për këto pyetje, por duke parë idetë e shumta që ka prodhuar mendja e njeriut, arsyeja nuk duket të jetë mjeti i duhur për të gjetur përgjigjet e këtyre pyetjeve hutuese, sepse ne nuk po kërkojmë çfarëdo përgjigjesh, por përgjigjet e sakta. Problemi është se në këtë fushë arsyeja nuk funksionon aq mirë.

Për shembull, përfytyro sikur dikush të ka dërguar te një ndërtesë e çuditshme. Ti po qëndron para derës së mbyllur të hyrjes dhe ai person të pyet: "Çfarë ka pas asaj dere? Çfarë ka pra brenda ndërtesës?" Sa mund të arrish të kuptosh përmes arsyes këtu? Disa

gjëra mbase mund t'i marrësh me mend, si: të pasurit e tavolinave, karrigeve, dritave dhe çezmave... por mund edhe të gabosh. Mund të jetë krejt bosh ose krejt e mbushur, ose ku ta di unë. Pra, si mund ta dish me bindje çfarë gjendet pas asaj dere? Nejse, ti mund të hysh dhe ta shohësh me sytë e tu se çka ka brenda, por sikur kjo të mos ishte e mundur? Atëherë, si do të mund ta kuptoje çfarë ka brenda?

Një mënyrë për ta kuptuar këtë është nëse dikush që ka qenë brenda ose dikush që njih dikë që ka qenë brenda të tregon. Tani, shtrohet pyetja: si mund t'i besosh atij personi? Si mund të jesh i sigurt se ai po e thotë të vërtetën?

Kështu është puna edhe me pyetjet e mëdha, si: cili qëllimi i jetës?, pse ka vuajtje?, a ka jetë pas vdekjes? etj. *Çfarë ka pas derës* është e ngjashme. Të gjitha këto janë të fshehura, të padukshme dhe të panjohura. Arsyeja nuk mund të arrijë në përgjigje definitive dhe nuk ka mundësi të jetë intuita ose thjesht ideja se “po e ndiej kështu” më e saktë se arsyeja.

Thjesht mund të kemi një shkallë më të lartë bindjeje kur na tregon dikush që i besojmë.

Natyrisht, arsyeja prapëseprapë na duhet, ndonëse nuk funksionon aq mirë si burim i drejtpërdrejtë njohurish për këto çështje. Megjithatë, prapë na duhet ta përdorim arsyen për të kuptuar se kujt t'i besojmë. Tash, të kthehemi te burri me pantallonat e kuqe: pse duhet ta pranoj ose ta refuzoj pretendimin e tij?

Fetë në përgjithësi bëjnë një pretendim mjaft të rrallë. Secila prej tyre pretendon se ka një mesazh nga Krijuesi, mesazh ky i cili mendohet të jetë ekskluziv për atë fe. Pra, pretendimi është ky: “Unë e kam mirë dhe të gjithë të tjerët e kanë gabim!” Shikuar nga pikëpamja e arsyes, ky pretendim në vetvete nuk është gjithaq problem. Fundja, nëse ky Krijues i Urtë do të na dërgonte një mesazh, do të kishte kuptim që ai mesazh të ishte konsistent. Rrjedhimisht, meqë disa fe të ndryshme bëjnë pretendime kontradiktore, nuk mund të kenë të gjitha të drejtë! Pra, sfida këtu është të vendosësh se cila fe është e saktë (nëse është ndonjëra). Është si të thuash se në vend që të vinte një person për të kontrolluar ujëmatësin, kanë ardhur shtatë.

Nuk është fundi këtu. Tani, duke parë gjithë ata njerëz të mbledhur para derës sate, duke përdorur të njëjtin proces arsyetimi, mund të arrish në disa mënyra të lehta për të zgjedhur se kush është personi që vërtet ka të drejtë të kontrollojë ujëmatësin. Për shembull, ai ose ajo mund të ketë një formë identifikimi dhe një uniformë me emrin e kompanisë së ujësjellësit së cilës ti i paguan faturën dhe ndoshta një pajisje për të lexuar matësin. Ngjashëm kemi disa shenja që mund t'i përdorim për të dalluar fenë e vërtetë nga ajo e rreme.

Meqenëse kjo është temë kaq e ndjeshme, ia vlen të ndalemi pak e të reflektojmë mbi llojet e testeve, që të shohim cili është më i vlefshëm. Një test i tillë mund të jetë ky: “Cili më ngjan mua dhe është nga raca ime?” A do ta përdorje këtë test për të

vendosur se kë do ta lejoje në shtëpinë tënde për të lexuar ujëmatësin? Në fund të fundit, kriminelët, ashtu si ujëmatësit, mund të jenë nga cilado racë dhe ngjyrë.

Po ky testi a bën: “Më lër të ndiej se cili mund të jetë i duhuri dhe pastaj do ta besoj aq shumë sa do të bëhet e vërtetë”? Jo! Sigurisht se jo. Po ai që të bën një ofertë vërtet të mirë, si kjo: "Nëse më beson mua si lexues i matësit të ujit, mund të kesh ujë falas përgjithmonë!" Tunduese, por e pamundur!

Ose mbase do të zgjidhje atë që i ngjan atij që shpesh e ke parë në oborrin e prindërve të tu (edhe pse ata kurrë nuk kishin pasur ujëmatës... hmmm!)

Po ai që duket më i zgjuar dhe më i pasur?

Nuk ma ha mendja!

Çështja këtu është se kur bëhet fjalë për fenë, duhet të hedhësh poshtë disa ide. E tillë është ideja se duhet të besosh atë që besonin paraardhësit e tu vetëm pse të duket e njohur, ose se i do ata me gjithë zemër ose nuk mund ta imagjinosh se ata mund të kenë gabuar! Jam i sigurt që edhe ti bën së paku disa gjëra ndryshe nga prindërit e tu. Pra, si ka mundësi që ata të gabojnë për disa gjëra të thjeshta dhe jo për fenë?

Thjesht nuk ka asnjë arsye bindëse që të bën të mendosh se besimi i prindërve dhe paraardhësve të tu ishte i saktë. Gjithashtu, nuk ka aspak kuptim të besosh ashtu verbërisht pa kurrfarë arsytimi të qëndrueshëm. Po ashtu, a është e arsyeshme që njeriu të besojë se feja e

vërtetë duhet të të bëjë të pasur, ose se thjesht duke besuar në një person ose një gjë të caktuar do të fitosh jetën e përjetshme? Sigurisht, njerëzit zakonisht arsyetojnë përzgjedhjen e një feje duke thënë se dikush tashmë ka ndjekur atë fe dhe ajo i ka ndryshuar jetën dhe e ka bërë të lumtur! Kjo, në fakt, ka kuptim, sepse është mjaft e arsyeshme të besojmë se feja e vërtetë duhet të ketë kështu ndikim, por problemi këtu është se shumë njerëz të tjerë kanë të njëjtin pretendim për fe të ndryshme. Duket se jemi krijuar për të qenë fetarë. Është pjesë e natyrës sonë. Nëse nuk ndjekim një nga fetë standarde, shpejt shpikim një të tillë! Pra, gjithmonë do të ketë një fe që do të na bëjë më të lumtur se fetë e tjera. Edhe një herë: vetëm pretendimi se feja jote është e vërtetë

sepse ta ka ndryshuar jetën nuk mund të jetë në vetvete kriter i shëndoshë, sepse atëherë edhe fetë e tjera duhet të jenë të vërteta se edhe ato ua kanë ndryshuar jetën njerëzve. Në fakt, edhe dikush që nuk beson fare se ka Krijues mund të pretendojë se ai ose ajo kishte ndjekur një fe më parë dhe tani që nuk e ndjek është më i lumtur dhe më i lirë, siç thotë populli: “Nëse bën për ty, bën edhe për mua.” Me fjalë të tjera, nëse vlen për njërin, duhet të vlejë edhe për tjetrin.

Pra, të gjitha këto janë thjesht pretendime. Pretendimet duhet të vërtetohen.

Pra, feja e vërtetë (nëse ka një të tillë) duhet të ketë ndonjë mjet identifikimi. Ajo duhet të ketë disa shënjes me anë të të cilëve mund të vërtetohet se e ka origjinën nga Krijuesi.

Atëherë, çfarë testesh mund të aplikojmë?

Kapitulli 3

TESTI I MËSIMEVE

Testi i parë, mbase edhe më i miri dhe më bindësi, sakaq eliminon shumicën e opsioneve.

Çfarë thonë fetë saktësisht për Krijuesin? Cila fe mëson se ekziston Një Krijues Unik, natyra e të Cilit është ndryshe nga ajo e krijesave, domethënë Një Krijues i Përjetshëm, i Vetëmjaftueshëm dhe Transcendent?

Nuk është qëllimi im këtu të kritikoj fetë dhe të tallem me to, pasi të gjitha fetë mësojnë dhe promovojnë një gamë të përbashkët moralesh dhe vlerash. Të gjitha ato kanë pikat e tyre të forta dhe të dobëta. Përkundrazi, qëllimi është vetëm t'i

shqyrtojmë ato në dritën e këtij kriteri të thjeshtë dhe të kuptueshëm botërisht.

Mbi bazën e këtij kriteri, ne kemi, ndoshta në mënyrë të diskutueshme, vetëm tre kandidatë të vërtetë: judaizmi, zoroastrianizmi dhe Islamin. Të krishterët mund të pretendojnë se kanë të drejtë të përfshihen në këtë kategori, por, të paktën, nga këndvështrimi i besimit normal të krishterë, krishterimi del të jetë i njëjtë me çdo fe tjetër që, në një mënyrë a një tjetër, ka komprometuar ose shtrembëruar konceptin e një Krijuesi Unik.

Për shembull, hinduizmi në përgjithësi ka një koncept panteist të Zotit. Kjo ide dikton se gjithçka është Zot. Universi, Toka, Hëna, yjet, pemët, kafshët dhe ne jemi të gjithë Zoti.

Si mund ta pranojë arsyeja një pretendim të tillë? Nëse me “Zot” nënkuptojmë Krijuesin, atëherë kjo i bie se krijesat janë krijuar vetë dhe krijesat janë Krijuesi. Si e shpjegon kjo renditjen e një universi të fundmë dhe çfarë dëshmie racionale ka për të mbështetur një pretendim të tillë? Kjo është me të vërtetë, si të thuash, se universi krijoi vetveten. Mirëpo, nëse nuk ka ekzistuar fare në radhë të parë, si do të mund ta kishte krijuar vetveten?

Gjithashtu, ne nuk ia atribuojmë universit aftësinë për të rregulluar dhe sistemuar. Nuk është një nga cilësitë ose atributet e tij. Universi përbëhet prej yjeve e galaktikave dhe vetë këto kanë nevojë për një Krijues. Meqenëse ato individualisht kanë nevojë për një organizator, atëherë edhe kolektivisht kanë po këtë nevojë!

Rrjedhimisht, një koleksion i gjërave në nevojë nuk ka si të bëhet i vetëmjaftueshëm. Një numër i madh njerëzish të uritur nuk kanë më shumë gjasa të ushqehen sesa një individ i uritur!

Krishterimi ka një problem të ngjashëm. Natyrisht, shumë të krishterë do të parashtronin të njëjtat argumente për ekzistencën e Krijuesit që kam paraqitur unë tashmë, por më pas do të vazhdonin të thoshin se Jezusi, një qenie e kufizuar, e fundme dhe nevojtare, është vetë Zoti. Problemi këtu është i qartë. Si mund ta pranojë arsyeja se një qenie mund të ketë dy forma të kundërta të ekzistencës në të njëjtën kohë? Si ka mundësi që një qenie të jetë edhe e fundme, edhe e pafundme në të njëjtën kohë? Si ka mundësi që një qenie të jetë edhe e vetëmjaftueshme, edhe

nevojtare, edhe e përjetshme, edhe e përkohshme, edhe e zakonshme, edhe unike, edhe një, edhe shumë në të njëjtën kohë?

Kjo është si të thuash, për shembull, se një rreth është bërë katror, por prapë ka mbetur rreth. Dikush mund të konceptojë idenë e drejtimit të vijës së një rrethi me forcë për ta bërë atë katror, por sigurisht që atëherë rrethi nuk mbetet më rreth. Ose, dikush mund të vendosë një rreth brenda një katrori ose një katror brenda një rrethi, por ajo formë kurrë nuk mund të jetë edhe katror, edhe rreth në të njëjtën kohë. Kjo në thelb është e pamundur dhe nuk mund të përdorësh kurrë një argument për të arsyetuar një gjë të pamundur. Pra, ky pretendim nuk mund të vërtetohet kurrë. Problemi kryesor është se kjo logjikë në

radhë të parë bie ndesh me argumentet e arsyes për ekzistencën e Krijuesit. Pra, nëse një qenie e krijuar, e fundme dhe nevojtare të mund të jetë vetë Krijuesi, pse të mos jetë edhe një tjetër kështu, e pastaj një tjetër e pastaj një tjetër? Si mund të mbrosh racionalisht një besim të tillë nga panteizmi, për shembull?

Përgjigjja ndaj kësaj është shpesh "E po, Zoti mund të bëjë gjithçka." Ky, natyrisht, është pretendim për Zotin dhe pretendimet për Zotin, si çdo gjë tjetër, duhet të vërtetohen. Është gjithashtu një deklaratë përplot me probleme. Për shembull, dikush mund të pyesë "A mund të pushojë Zoti së ekzistuari?", ose: "A mund të bëjë Zoti diçka të keqe?"

Ka dy përgjigje të zakonshme për një pyetje të tillë. Ose: "Jo, ai nuk mundet", gjë që bie

ndesh me pretendimin e të krishterëve se Zoti mund të bëjë çdo gjë, ose: "Po, mundet, nëse do, por Zoti nuk do të bënte kurrë keq, sepse natyra e Zotit është e mirë."

Pse atëherë kjo vlen për mirësinë e Zotit, por jo për cilësitë e tjera të Tij? Saktësisht i njëjti kriter vlen për të qenët e Zotit Një, i Përjetshëm dhe i Vetëmjaftueshëm. Ashtu siç nuk është në natyrën e Zotit të Mirë të bëjë të keqen, njëjtë nuk është në natyrën e Krijuesit të Përjetshëm, të Vetëmjaftueshëm, që të bëhet krijesë e përkohshme dhe nevojtare. Pra, pretendimi se Krijuesi u bë krijesë dhe ende mbeti Krijues, është pretendim që nuk mund të vërtetohet kurrë, pasi është gjë e pamundur dhe kjo vlen për çdo fe që bën një pretendim të tillë për Krijuesin. Kjo gjithashtu përjashton shumicën e asaj që

hindusët dhe paganët besojnë pasi ata bëjnë pretendime të ngjashme rreth Krijuesit duke thënë se është mishëruar në një qenie të krijuar.

Disa të krishterë mund të pretendojnë se nuk e konsiderojnë Jezusin Zot, por bir të Zotit. Problemi këtu është se çfarë nënkuptohet me "biri i Zotit"? Një bir njeriu është njeri si nëna dhe babai. Atëherë, a i bie që edhe biri i Zotit të jetë zot? Nëse po, kjo na kthen te pika fillestare dhe prapë kemi të njëjtin problem si më parë. Po ashtu, fëmija është produkt i një akti martesor. Atëherë, a i bie kjo që Zoti paska grua? Kjo do të binte qartazi ndesh me gjithçka që dimë deri tani për Zotin, i Cili nuk u ngjan krijesave. Atëherë, a ka mundësi që Zoti të ketë birësuar Jezusin? As kjo nuk ka kuptim, sepse vetëm ajo që është e llojit të

njëjtë mund të birësohet. Për shembull, nëse dikush ka një peshk me emrin Fllapi dhe thotë: "Ky është djali im", askush nuk do ta merrte seriozisht. Ti mund ta duash atë si birin tënd, mund të hajë me ty dhe të ketë një dhomë në shtëpi, mbase edhe mund ta birësosh zyrtarisht, por peshku është peshk, ndërsa ti je njeri. Nuk janë njësoj këta dy dhe ne e dimë mirë se Krijuesi nuk i ngjan asgjëje në univers. Ç'është e vërteta, ne u ngjajmë më shumë peshqve sesa Krijuesit. Ne jemi qenie të kufizuara, të fundme, nevojtare, e edhe peshqit janë ashtu, ndërsa Krijuesi është i Përjetshëm dhe i Vetëmjaftueshëm. Në fakt, Krijuesi duhet të jetë shumë larg të pasurit një djalë, qoftë në kuptimin e plotë të fjalës, qoftë simbolikisht, përveç ndoshta në kuptimin shumë metaforik të prindit që kujdeset,

udhëheq dhe edukon fëmijën. Kështu pra edhe Krijuesi. Megjithatë, ky term, po të përdorej, do të vlente për të gjitha krijesat, jo vetëm për njerëzit, e lëre më vetëm për një njeri.

Budizimi, në anën tjetër, e përjashton Krijuesin pothuajse tërësisht. Rrjedhimisht, budizmi mbetet më shumë filozofi sesa fe. Kjo në vetvete është problem, sepse shpjegimin për qëllimin e jetës, arsyen e vuajtjeve dhe të panjohurën e madhe të jetës së përtejme e merr nga një njeri, jo nga Zoti. Neve na nevojitet diçka e prerë dhe bindja mund të vijë vetëm nga Njohësi i së padukshmes, i Cili njëkohësisht është Krijuesi i së padukshmes. Gjithçka tjetër është spekulim.

Mund të përmenden disa fe të tjera. Kështu, sikhizmi është i ngjashëm me budizmin në

kuptimin që nuk pretendon të ketë origjinë hyjnore, të paktën jo drejtpërdrejt. Themeluesi i sikhizmit, Guru Nanak, mori ato që ai mendonte se ishin pjesët më të mira të hinduizmit e të Islamit dhe i bashkoi për të krijuar rrugën e tij. Edhe ne mund të tundohe mi të bëjmë një përzierje të tillë përballë një zgjedhjeje të tillë. Megjithatë, këtu ka një problem të thjeshtë racional. Nëse pajtohemi se me të vërtetë ka një shpallje dhe mesazh nga Krijuesi, atëherë si mund të vendosim racionalisht të braktisim udhëzimin e Krijuesit dhe të ndjekim diçka tjetër ose ta përziejmë atë me diçka tjetër (përveç nëse mund të vërtetojmë se Krijuesi me të vërtetë kërkon këtë prej nesh)? Kjo mbase mund të justifikohet nga këndvështrimi hindus, por është shumë e

vështirë të justifikohet, bie fjala, nga pikëpamja e Islamit ose judaizmit.

Tashmë kemi zbatuar një test për të parë nëse pretendimi i një feje se është nga Krijuesi është i vlefshëm apo jo: a pajtohet me parimin bazik, racional se ekziston një Krijues i Vetëm, Unik, i Përjetshëm dhe i Vetëmjaftueshëm, i Cili dallon nga krijesat dhe është i ndarë prej tyre? Pastaj, a ka ndonjë kriter tjetër që mund të zbatohet për të zvogëluar listën tonë të kandidatëve?

Kapitulli 4

Atëherë, kemi edhe teste të tjera që mund të zbatohet për të parë se a është një fe e saktë apo jo. Një nga këto teste, që është goxha i arsyeshëm, është ideja e universalitetit. Ajo që nënkuptohet me këtë është se ky mesazh nga Krijuesi duhet të jetë për të gjithë. Për sa kohë që njerëzit në përgjithësi kanë aftësinë racionale për të kuptuar arsyet e ekzistencës së Krijuesit dhe për të bërë pyetje të thella e thelbësore rreth jetës, vdekjes, universit dhe gjithçkaje tjetër, duket e paarsyeshme që Krijuesi t'i japë udhëzime vetëm një grupi njerëzish e t'i përjashtojë të gjithë të tjerët. Sigurisht se Krijuesi mund të zgjedhë një grup të caktuar për të bartur dhe ndjekur këto udhëzime të urta, ashtu siç mund të zgjedhë t'i japë mesazhin vetëm një personi të dalluar, në

vend që t'i flasë gjithsecilit individualisht. Megjithatë, lind pyetja: nëse nuk jemi nga ai grup i zgjedhur, çfarë duhet të bëjmë? Çfarë ndodh me ne? Gjithë kjo pastaj bëhet disi e parëndësishme. Duket e çuditshme që Krijuesi, i Cili i ka siguruar çdo njeriu mjetet për të përmbushur çdo nevojë, të mos u sigurojë atyre mjetet për të përmbushur nevojën më të madhe psikologjike, mendore dhe shpirtërore: përgjigjet e pyetjeve të mëdha!

Kjo mund të themi se e eliminon edhe hebraizmin. Hebraizmi është i mrekullueshëm për ty nëse ke lindur nga një grua hebraike, e, nëse jo, nuk del të jetë aq i mirë. Edhe pse shumë prej nesh priren të mendojnë se disi vendi, raca, fisi, qyteti ose ekipi ynë i futbollit është më i miri (ose të paktën do të jetë një ditë), shumica prej

nesh do ta kishin shumë të vështirë ta kuptonin idenë se, nëse nuk ke lindur në një racë ose fis të caktuar, as që shpreson ta arrish lumturinë e përjetshme të parajsës pas vdekjes dhe se udhëzimi plot urtësi i Krijuesit është vetëm për një grup të zgjedhur dhe jo për ty. Pra, edhe nëse do të ishte e vërtetë, prapëseprapë shumica prej nesh do ta hidhnin poshtë si të parëndësishme! Ka disa arsye të tjera pse hebraizmi mund të hidhet poshtë racionalisht, por tash nuk është koha për këtë.

Këtu më duhet të ndalem pak për një ndërhyrje të shkurtër.

Tani, të kam paralajmëruar qysh në fillim se nuk do të të pëlqejë libri!

Ndoshta duhet të të kisha paralajmëruar pak më shumë se përfundimet e kësaj qasjeje racionale mund të të çojnë plotësisht kundër dëshirave të tua dhe gjërave që mendon se i dëshiron në jetë. Ndoshta duhet të të kisha paralajmëruar se mbase do ta urresh të vërtetën dhe, nëse je asi personi që mendon se e ke jetën krejtësisht në rregull dhe se tashmë ke gjithçka që do në jetë... e po, do të mund të të kisha paralajmëruar se ka shumë arsye pse gjërat mund të mos vazhdojnë kështu për ty gjatë. Ama, nëse je kësi personi, me siguri nuk do të më dëgjoje. Sidoqoftë, ja pra.

PARALAJMËRIM!

Ajo që vijon është vetëm për njerëzit që janë vërtet të gatshëm të mënjanojnë paragjykimet, të mendojnë pak thellë dhe të ndjekin përfundimin më të arsyeshëm.

Deri këtu ka qenë lehtë. Ajo që vijon do të jetë paksa e vështirë kur bëhet fjalë për përfundimet dhe vendimet që duhet t'i marrësh. Nuk po mundohem të të largoj. Jo, vërtet. Rri, se ia vlen. Fundja, a mund të arrihen gjërat e çmuara me pak punë? Eh pra, përfundimet te të cilat po të çoj kërkojnë pak përpjekje. Në fakt, disave do t'u duhet një përpjekje shumë serioze.

Puna e vështirë këtu nuk është fizike, madje as mendore në kuptimin e të menduarit shumë. Nëse je pajtuar të përdorësh arsyen dhe sensin për të arritur në përfundime dhe

nëse je gati të zgjedhësh optionin më të arsyeshëm dhe të tjerat s'kanë rëndësi për ty, atëherë mendoj se s'do të kesh problem. Disa prej jush do të hasni në probleme. Disa prej jush që e lexojnë këtë madje mund të pajtohen me gjithçka dhe pastaj thjesht të vazhdojnë të jetojnë ashtu si më parë..., ose të paktën do të përpiqen. Po them "do të përpiqen" sepse praktikisht nuk do të mund të vazhdojnë jetën si përpara. Këtë po e them nga përvoja. Ajo që vijon do të të çojë në një përfundim që për disa mund të jetë një e vërtetë tronditëse. Disa ndoshta e kanë pritur këtë. Pasi ta dish të vërtetën, një gjë është e sigurt: jeta jote do të ndryshojë përgjithmonë. E vërteta do të qëndrojë gjithmonë me ty. Sado që do t'i ikësh, nuk mund të ikësh nga vetja.

JENI PARALAJMËRUAR!

Pra, kthehemi aty ku e lamë...

Tash kemi mbetur me dy kandidatë potencialë: zoroastrizmin dhe Islamin.

Islami ka disa përparësi kundrejt zoroastrizmit. Së pari, Islami pretendon të jetë fe universale për të gjithë. Ndryshe nga çfarë mund të mendojnë disa njerëz dhe disa pasues të Islamit, Islami nuk është fe arabe, pakistaneze ose indiane. Për njerëzit e bardhë që flasin anglisht është po aq sa është për arabët, afrikanët e eskimezët.

Është interesante se fjala “Islam” është fjalë arabe që ka kuptim dhe është term përshkrues që do të thotë “nënshtrim” ose “dorëzim” ndaj Krijuesit. Rrjedhimisht, musliman është ai që pretendon se zbaton dhe ndjek udhëzimet e Krijuesit. Islami po ashtu pretendon se ky mesazh themelor i

besimit dhe ndjekjes së Zotit Një, Unik dhe Tanscendent është mesazhi themelor që Krijuesi e ka shpallur vazhdimisht nëpërmjet njerëzve të veçantë, të zgjedhur dhe të njohur si profetë ose të dërguar. Emri i kësaj feje nuk lidhet me ndonjë konkret ose vend të caktuar. Judaizmi (Juda), krishterimi (Krishti), budizmi (Buda), hinduizmi (India), zoroastrizmi (Zoroastri), që të gjithë lidhen me një person ose vend. Kështu, për shembull, nëse dikush jeton në një vend të largët dhe nuk ka dëgjuar kurrë që një njeri i quajtur Jezus, i cili është gjithashtu Zot dhe bir i Zotit, ka vdekur për mëkatet e dikujt, asesi nuk mund të arrijë ta kuptojë këtë nëpërmjet mendjes së tij ose nëpërmjet përvojës. Nuk mund ta racionalizojë kurrë. Dikush duhet t'i tregojë. Me Islamin nuk është kështu. Ideja bazë e Islamit, se

ekziston një Krijues Unik, udhëzimet e të Cilit duhet t'i ndjekim, është diçka që çdokush kudo mund ta kuptojë. Si ide, Islami, përkatësisht nënshtrimi ndaj Zotit të Vetëm, është vërtet universal.

Kapitulli 5

TESTI I KARAKTERIT

Mund të aplikohen edhe disa teste të tjera.

I pari lidhet me karakterin dhe personalitetin e personit që bën pretendimin. Nëse personi që pretendon se ka një mesazh nga Krijuesi është i njohur dhe shfaq vërtetësi, sinqeritet e ndershmëri, atëherë e ke të lehtë të pranosh se ai po thotë gjithashtu të vërtetën për mesazhin që po merr nga Krijuesi. Natyrisht, kjo mund të kundërshtohet me pretendimin se ky person thjesht mund të ketë deluzion. Mbase ai vërtet mendon se është ai që pretendon të jetë dhe është i ndershëm e i sinqertë, por përjetimet e tij janë fryt i

lajthitjeve mendore ose iluzioneve. Si mund ta dimë se nuk është kështu?

Kuptohet se asnjëri prej nesh nuk dëshiron të tradhtohet ose të mashtrohet nga një mashtrues ose të përfundojë duke ndjekur një të çmendur. Dihet, një mashtrues i mirë do të bëjë gjithçka që mundet që të bëjë të besosh se është i sinqertë dhe i vërtetë. Ai me siguri mesazhin që ka do ta bëjë të duket dhe të tingëllojë si i vërtetë dhe shpesh do të të tundojë me oferta që duken shumë të mira për të qenë të vërteta. Problemi këtu është se lehtë mund të përfundojmë atje ku kemi filluar. Të gjithë pretenduesit tanë mund të dalin persona mjaft të besueshëm, por, ç'është e vërteta, këtu nuk kemi të bëjmë me vetë pretenduesit. Nuk janë Moisiu, Krishna, Buda, Zoroastri, Jezusi, Muhamedi ose Guru

Nanak ata që po na trokasin në derë, po janë njerëzit që pretendojnë se i përfaqësojnë ata dhe mësimet e tyre. Kemi gjëra të thëna dhe të shkruara në lidhje me këta persona. Pra, para se të mund t'i shqyrtojmë këta persona, duhet të gjejmë një mënyrë për të dalluar të thënat e tyre nga ato që u janë veshur atyre.

Mu për këtë është aq e rëndësishme çështja e autenticitetit të shkrimeve të shenjta. Problemi i zoroastrizmit është se nuk ka mbetur asgjë e vërtetë nga shkrimet dhe thëniet e vetë Zoroastrit. Liturgjia e tij ka mbetur siç kanë mbetur disa ide të teologjisë bazë, por vetë fjalët e tij janë pothuajse të humbura. Problemet me vërtetësinë e Biblës janë të njohura, madje edhe te dijetarët e mirëfilltë të krishterë dhe hebrenj. Pikërisht në këtë fushë Kurani,

teksti kryesor i Islamit, është me të vërtetë i spikatshëm. Ka shumë pak mospajtim mbi autenticitetin e tekstit kuranor. Ç'është e vërteta, kushdo mund të marrë një kopje Kurani në çfarëdo xhamie, kudo në botë, dhe ta krahasojë me dorëshkrimet më të vjetra të Kuranit që datohen brenda tridhjetë vjetësh pas vdekjes së profetit Muhamed dhe do të gjejë tekstin të pandryshuar, me përjashtim të stilit të shkronjave dhe disa shenjave të vendosura në shkronja për të ndihmuar shqiptimin. Është shumë mahnitëse kur kemi parasysh se po bëhet fjalë për një tekst të vjetër më shumë se 1400 vjet. Jo vetëm që ka një rekord të shkëlqyer të ruajtjes në të shkruar, por Kurani ka një histori të mrekullueshme të ruajtjes në formë gojore po ashtu. Muslimanët pohojnë se shkrimet

e tjera të shenjta janë ndryshuar, kanë humbur dhe janë shtrembëruar në mënyra të ndryshme, por Krijuesi (fjala e të cilit është Kurani) ka premtuar se do të ruajë Kuranin sepse ai është shpallja e fundit nga Krijuesi për njerëzimin dhe kështu Muhamedi është i Dërguari i fundit. Edhe pse muslimanët vetë janë njerëz të gabueshëm, dhe si të tillë nuk përfaqësojnë denjësisht imazhin e vërtetë të fesë, Kurani, shembulli dhe mësimet e Profetit mbeten të pastra, ashtu që përmes tyre njerëzit të mund të gjejnë udhëzimin e vërtetë të Zotit. Këtë e pretendojnë muslimanët, por a nuk ka Islami shumë probleme?

Dua të them: si mund të pritet që dikush në botën e lirë e të qytetëruar, ose kudo tjetër në botë, të ndjekë një fe që është 1400 vjet e vjetër? Kjo fe duket se i trajton gratë si

qytetare të rendit të dytë (në botën tonë të lirë e të civilizuar gratë ende paguhen më pak se burrat, vazhdimisht paraqiten si objekte seksi, vuajnë jashtëzakonisht shumë abuzim seksual e fizik dhe e kanë pothuajse të pamundur të respektohen si nëna dhe bashkëshorte; megjithatë, në botën e qytetëruar, ne së paku pretendojmë se gratë duhet të jenë të barabarta). A nuk është e vërtetë se Kurani thotë që ta rrahësh gruan në raste të caktuara? Pastaj, burrat mund të kenë deri në katër gra dhe skllave pakufi! Burrat janë të favorizuar, pra. Ata marrin dyfishin e trashëgimisë që merr gruaja dhe dëshmia e një gruaje vlen sa gjysma e dëshmisë së një burri!

Pastaj kemi çështjen e xhihadit, terrorizmit dhe mësimëve, siç janë: “Luftoni dhe vritni

jobesimtarët kudo që t'i gjeni!”, e kështu me radhë.

Po ashtu, kemi gjithë ato ligje që duken shumë barbare, siç janë: prerja e dorës për hajdutët, ekzekutimi për mosbesim e amoralitet (pse gjithmonë vetëm gratë vriten?), ekzekutimi për homoseksualizëm, fshikullimi për pijanecët, madje kryqëzimi për grabitësit e rrugës!

A nuk është Kurani, sikurse çdo libër tjetër fetar, përplot kundërthënie, terma të paqartë dhe i hapur për shumë interpretime të mundshme?

Eh pra, Kurani duket të jetë ndryshe nga çdo shkrim tjetër i shenjtë nga një aspekt së paku, që është fakti pothuajse i padiskutueshëm i ruajtjes dhe origjinalitetit të tij. Megjithatë, a thua sa prej problemeve

që njerëzit kanë me Islamin në të vërtetë vijnë nga mësimet e Kuranit dhe të Pejgamberit e jo nga sjellja e muslimanëve? Le ta shohim këtë racionalisht e jo emocionalisht.

Nëse disa mësimet e Kuranit bien ndesh me zakonet dhe normat me të cilat jemi mësuar, a do të thotë kjo se ai nuk është nga Krijuesi? Jo vetëm kjo, por, në fakt, nuk ka kurrfarë arsyeje racionale që çështjet e lartpërmendura ta pengojnë Kuranin nga të qenët hyjnor. Po sikur të mos jetë i përshtatshëm për kohën “moderne”? E po, ndoshta Krijuesit nuk i pëlqen modernizmi ose ndonjë ideologji tjetër e krijuar prej njeriut. Nuk po them se kështu është, por thjesht po vërtetoj poentën që kjo nuk është arsye për të hedhur poshtë pretendimin e Kuranit se është prej

Krijuesit. Në këtë aspekt, edhe fetë e tjera, sikurse Islami, vënë në pikëpyetje vlefshmërinë e një jetese të bazuar krejtësisht në materializëm e kënaqësi, gjë që duket se karakterizon kryesisht jetën moderne.

Është problem të gjykosh një libër ose shkrim të shenjtë vetëm mbi bazën e moraleve dhe ligjeve të tij, sepse morali dhe ligjet në përgjithësi janë larg të qenit universale. Për shembull, diçka që mund të duket si dënim i ashpër në një kulturë, konsiderohet gjë e butë në një tjetër. Poligamia e limituar mund të duket si kufizim i paarsyeshëm në një shoqëri që e sheh martesën si mjet sigurie shoqërore për gratë dhe, për rrjedhojë, praktikon poligaminë e palimituar. Monogamia mund të duket çmenduri për ta, veçanërisht për

gratë që mbështeten te poligamia për siguri. E vetëquajtura "bota e lirë dhe e qytetëruar" po ndryshon vazhdimisht qëndrimet e saj morale dhe etike për shumë gjëra. Gjërat që ishin të këqija dhjetë vjet më parë, janë të pranueshme sot, dhe anasjelltas. Megjithatë, disa zëdhënës të vlerave të "botës së lirë" flasin për moralin dhe vlerat e tyre sikur të ishin hyjnore ato, gjë që natyrisht nuk janë. Në fakt, është krejt e kundërta.

Çështja këtu është se problemi më i madh që njerëzit zakonisht kanë me Islamin nuk është në të vërtetë fare kriter i vlefshëm për ta gjykuar atë. Nëse flasim racionalisht, qëndrimi ynë duhet të jetë se, nëse mund të gjejmë dëshmi bindëse për origjinën hyjnore të një libri, atëherë duhet të pranojmë se Krijuesi ynë e di më së miri

çfarë është më e mira për ne. Në të vërtetë, është mjaft e mundshme që njerëzit të zgjedhin morale, ligje dhe vlera të cilat u përshtaten më tepër sesa ato që vërtet janë të mira dhe të dobishme për ta. Ose që disa njerëz (për shembull ata që kanë autoritet dhe pushtet) të krijojnë një sistem të moraleve që i mban ata në pushtet! Ç'është e vërteta, ka shumë gjëra që janë të mira për ne e nuk i pëlqejmë, por, në anën tjetër, ka shumë gjëra që i pëlqejmë, porse realisht janë të këqija për ne. Shkurt, këtë çështjen e së ashtuquajturës përshtatshmëri të Islamit me jetën moderne duhet ta lëmë mënjanë dhe ta trajtojmë si një hile çorientuese (ose si një burrë tjetër me pantallona të kuqe!).

Tash është koha për të gëlltitur kafshatën më të hidhur nga të gjitha deri tani. Është

koha për të pranuar atë që për disa prej nesh mund të jetë e vërteta më e rëndë, pra, që Kurani ndoshta mund të jetë udhërrëfyesi nga Krijuesi dhe se Muhamedi mund të jetë Profet. Ne, së paku, duhet të lëmë mënjanë paragjykimin tonë dhe të përpiqemi të shqyrtojmë hapur argumentet racionale të paraqitura në favor të pretendimit të Kuranit se është ai udhërrëfyes. Në fund të fundit, tashmë janë disa gjëra në favor të këtij pretendimi. Le t'i shikojmë edhe një herë. Së pari, ajo që Kurani thotë për Krijuesin përputhet me atë që mund të kuptohet në mënyrë racionale nga të gjithë kudo, domethënë se ekziston një Krijues që nuk është si krijesat. Ka shumë ajete kuranore që e shpjegojnë këtë ide. Për shembull:

“Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as lind, as është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Të!” (Kurani; Kapitulli 112, *Sinqeriteti*, 1-4)

Disa njerëz vënë në pikëpyetje përdorimin e përemrit “Ai” në Kuran. A do të thotë kjo se Krijuesi është njeri? Në fakt, sipas këtyre ajeteve, Krijuesi nuk është si diç tjetër, porse arabishtja, gjuha origjinale e Kuranit, si shumë gjuhë të tjera, ka vetëm përemra mashkullorë dhe femërorë, e jo asnjans. Edhe në shqip, t’i referohesh Zotit me “kjo gjë” nuk duket fare mënyrë e përshtatshme për të folur për Zotin. “Ai” thjesht është termi gjinor që përdoret në Kuran, por nuk nënkupton e as kërkon që Zoti të jetë njeri ose mashkull.

Gjëja e dytë në favor të Islamit është se Kurani është ruajtur në mënyrë të jashtëzakonshme. Vetë historia e kësaj ruajtjeje ia vlen të studiohet. Mirëpo, për të mos e zgjatur, po paraqes vetëm disa komente të disa studiuesve të ndryshëm për këtë çështje.

Orientalisti Riçard Burton shkruan se Kurani që kemi sot është teksti që na ka ardhur në formën në të cilën është organizuar dhe miratuar nga Profeti... Ajo që ne kemi sot në duart tona është mushafi (teksti) i Muhamedit. Keneth Krag e përshkruan transmetimin e Kuranit nga koha e shpalljes deri te ne si diçka që ka ndodhur në “një sekuencë të pandërprerë e të gjallë të devotshmërisë”. Shvalli, në *Geschichte des Qurans*, shkruan: “Sa u përket pjesëve të ndryshme të shpalljes, mund të jemi të

sigurt se teksti i tyre në përgjithësi është transmetuar saktësisht siç është gjetur në trashëgiminë e Profetit.”

Këta duken se janë goxha të bindur për vërtetësinë e Kuranit, apo jo?

Arsyeja e tretë që duhet të kemi parasysh dhe t’i kushtojmë vëmendje është fakti se mesazhi i Islamit pretendon të jetë universal, pra, për të gjithë, pavarësisht nga raca e statusi i personit. Madje, Islami sqaron se Krijuesi nuk shikon ngjyrën, racën, fisin, pasurinë ose statusin e një personi, por zemrën, mirësinë dhe veprat e tij.

Kurani, megjithatë, nuk është i lehtë për t’u lexuar. Mund të jetë shumë i vështirë për t’u kuptuar, pasi nuk ndjek ndonjë renditje të caktuar ngjarjesh, temash ose tematikash. Ai përsërit veten shumë, madje përkthimi

më i mirë është shumë sfidues. Në fakt, për ta kuptuar atë, duhet të mendosh dhe pikërisht të menduarit e kërkon Kurani shumë prej nesh.

Pavarësisht kësaj, mesazhi bazë është shumë i qartë. Ekziston vetëm Një Zot, i Cili është i Dashur dhe i Mëshirshëm për të gjitha krijesat e Tij, veçanërisht për ata që janë të përlurur dhe besimtarë. Ai është gjithashtu i ashpër në ndëshkimin e atyre që janë mendjemëdhenj dhe refuzojnë të vërtetën. Jeta është një test dhe, pasi të vdesim dhe universi që e njohim të marrë fund, do të vijë një ditë kur do të rikrijohemi fizikisht dhe do të gjykohe mi. Pastaj, ose do të shpërblehemi me lumturi të përjetshme, ose do të ndëshkohemi me mundim të përjetshëm. E po, të thashë në fillim se do të ketë gjëra që nuk do të të pëlqejnë, siç

janë vdekja dhe ferri! Megjithatë, fakti që nuk na pëlqen diçka nuk e bën atë gjë të pasaktë ose të pavërtetë.

A ka ndonjë gjë tjetër që mund të na ndihmojë të pranojmë pretendimin e Kuranit se është nga Krijuesi i qiejve dhe Tokës? Po, vetë Kurani jep një test falsifikimi. Ky, në fakt, është test i mirë për t'u përdorur për çdo libër që pretendon se është nga Krijuesi:

“A nuk përsiatin ata për Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.” (Kurani; Kapitulli 4 - *Gratë*, 82)

Çështja këtu është se, nëse një libër është nga Krijuesi i gjithçkaje është mjaft racionale të arrihet në përfundimin se kjo Qenie Unike është shumë inteligjente dhe e

mençur deri në një shkallë që është përtej të kuptuarit njerëzor. Sigurisht që pritet si Krijuesi i gjithçkaje të dijë si funksionon bota natyrore dhe universi, si dhe të njohë ngjarjet e historisë së njerëzimit.

Kurani është i jashtëzakonshëm, jo vetëm për faktin se nuk ka kontradikta, por gjithashtu për faktin se bën deklarata për historinë, teologjinë, filozofinë, ligjin dhe botën natyrore, të cilat nuk mund të kenë një shpjegim normal njerëzor.

Gjithashtu Kurani ka një cilësi tjetër të jashtëzakonshme, që është se ai edhe sot mbetet shkrimi më i lartë në gjuhën arabe. Në fakt, vetë Kurani i sfidon arabët, të cilët kanë qenë mjeshtër të poezisë dhe aftësive gjuhësore, të prodhojnë qoftë dhe një kapitull që mund të krahasohet me të. Kapitulli më i shkurtër i Kuranit është vetëm

me tri ajete! Në një kohë kur poetët ishin elita e Arabisë, Muhamedi nuk kishte shfaqur aftësi poetike, as para, as pas shpalljes së Kuranit. Në fakt, thëniet e tij janë qartazi të ndryshme gjuhësisht nga Kurani dhe mund të dallohen lehtësisht. Shumë poetë dhe oratorë më të aftë të asaj kohe pranuan se këto nuk ishin fjalë të Muhamedit, madje as fjalë njeriu. Shumë e përqaftuan Islamin vetëm nga dëgjimi i recitimit të Kuranit. Për ta kjo ishte prova më bindëse e origjinës hyjnore të Kuranit. Sigurisht se kjo është e vështirë për ne që ta vlerësojmë sot, por qëndron si fakt historik. Shtrohet pyetja se si dikush pa dhunti të shquara poetike ishte në gjendje të prodhonte një vepër që është më e larta deri më sot në gjithë gjuhën arabe në një kohë kur prodhoheshin poezitë më të

mëdha të letërsisë arabe. Po ta krahasojmë këtë fakt me diçka të ngjashme në ditët e sotme, është po aq e jashtëzakonshme sa një person i paarsimuar dhe pa njohuri shkencore ose trajnim të shpjegojë një teori të përsosur dhe të unifikuar të fizikës!

Muhamedi, si shumica e njerëzve në Arabi në atë kohë, nuk dinte shkrim-lexim. Nuk kishte qasje në mjetet e nevojshme për të siguruar një njohuri të tillë. Në të vërtetë, ishte prore sfidë e kundërshtarëve të profetit Muhamed të gjenin se prej ku saktësisht i merrte gjithë ato informata, ashtu siç ka qenë sfidë përgjatë historisë për ata që refuzonin të pranonin se Kurani është nga Krijuesi. Disa të krishterë polemizues madje shkuan aq larg sa thanë se Muhamedi ka qenë në fakt një peshkop i krishterë heretik që ka ikur në Arabi, ndërsa

disa të tjerë kanë deklaruar se ai kishte mësuar nga një murg disident! Megjithatë, përkundër historisë së pasur dhe literaturës së bollshme mbi jetën e Muhamedit, askush nuk ka arritur të identifikojë këtë person (murgun) dhe të zbulojë se si arriti të qëndronte i fshehur për periudhën njëzetetrevjeçare të predikimit të Profetit. Pastaj, kjo pikëpamje ngre një çështje tjetër, që është supozimi se Kurani ishte një shpikje dhe se Muhamedi ishte gënjeshtar. Prapëseprapë, një pretendim i tillë është shumë problematik, pasi çdo studim i jetës së Muhamedit tregon qartë sinqeritetin dhe vërtetësinë e tij të plotë. Ai nuk i përshtatet aspak përkufizimit psikologjik të një mashtruesi. Rrjedhimisht, kjo ka bërë që disa të pretendojnë se atë e kishin kapur deluzionet dhe çmenduria, kështu që me të

vërtetë besonin se ishte profet, andaj arriti ta bindte vetveten dhe të tjerët për këtë. Megjithatë, kjo prapë na lë të pazgjidhur misterin e burimit të informatave mahnitëse dhe gjerësinë e njohurive të Kuranit.

Pra, një person nuk mund të jetë mashtrues dhe gënjeshtar në të njëjtën kohë. Nëse mendon se je profet dhe vërtet beson se merr njohuri nga Zoti, kur dikush të bën ndonjë pyetje të vështirë, - siç i ka ndodhur shpesh Muhamedit, - nuk vrapon te prifti ose rabini më i afërt për të marrë përgjigjen. Përkundrazi, je i bindur që Zoti do të ta japë përgjigjen.

Përfundimi më i arsyeshëm që shpjegon fenomenin e nivelit mahnitës të informatave në Kuran dhe po ashtu sinqeritetin dhe vërtetësinë e qartë të

Muhamedit është se ai ishte me të vërtetë i Dërguari i Zotit, tamam siç pretendonte. Ky del të jetë shpjegimi më i besueshëm për informatat që gjenden në Kuran, sepse kjo njohuri është nga Krijuesi, kështu që shërben si verifikues njëkohësisht. Pastaj, sinqeriteti, vërtetësia dhe sjellja parimore e profetit Muhamed tregon se me të vërtetë ishte kush pretendonte se ishte dhe se po merrte një mesazh hyjnor.

Kapitulli 6

NIVELI MAHNITËS I INFORMATAVE

Me siguri je duke menduar me vete se çfarë saktësisht është ky “niveli mahnitës i informatave” që kam përmendur këtu. Kjo është temë e gjerë për të cilën do të mund të shkruanim vëllime të tëra dhe, pastaj, po të shtonim të gjitha argumentet dhe kundërargumentet e temës, do të duhej të shkruanim më tepër vëllime! Kam përmendur disa libra dhe faqe interneti në fund të këtij libri, nëse je i interesuar t’i shkosh thellë kësaj çështjeje. Megjithatë, këtu kam zgjedhur vetëm disa gjëra që më duken shumë mahnitëse dhe bindëse.

E para ka të bëjë me historinë. Shumë të krishterë kanë akuzuar Muhamedin se është përpjekur të kopjonte dhe të përdorte

Biblën, gjë që është shumë e pakuptimtë, për disa arsye. Një prej tyre është sepse thjesht nuk kishte Bibël në gjuhën arabe në atë kohë. Mirëpo, edhe sikur të kishte, Muhamedi nuk do të mund ta lexonte. Tash, është e vërtetë se ka shumë persona që janë përmendur në Kuran, të cilët janë edhe në Bibël. Kjo është kështu për shkak se ata janë, kryesisht, profetë dhe të dërguar të Zotit. Kurani, duke qenë shpallja e fundit nga Krijuesi, i konsideron jetët e atyre njerëzve si shembuj të denjë për t'u përmendur si frymëzim dhe motivim për besimtarët pas tyre. Nuk është e çuditshme që përmendet Abrahami, pasi arabët e konsideronin atë patriarkun e tyre nëpërmjet djalit të tij, Ismaelit. Madje, një nga termat biblikë që u referohet arabëve është “ismaelitët”, për shkak të prejardhjes

së tyre prej Ismaelit. Megjithatë, ajo që mund të duket e çuditshme dhe sfiduese për t'u shpjeguar është se sa shumë përmendet Moisiu në Kuran. Natyrisht, shpjegimi më i thjeshtë për këtë është se sfidat dhe detyrat me të cilat përballej Muhamedi ishin shumë “të ngjashme” me ato të Moisiut, rrjedhimisht përvoja e Moisiut ishte udhërrëfyes dhe frymëzim i dobishëm për të Dërguarin e fundit.

Janë dy detaje interesante të marra nga disa ngjarje në Kuran, të cilat, ndonëse të vogla, tregojnë shumë.

Së pari, është shumë interesante se si Jozefi (i biri i Izraelit ose Jakobit), përmendur gjithashtu në Kuran, sundimtarin e Egjiptit kurrë nuk e thërret Faraon, por e quan Mbret, ndërsa Moisiu qartë e quan Faraon. Ndërkohë, Bibla të dy i quan faraonë. Duket

e parëndësishme, mirëpo kur gjejmë Jozefin në histori, gjejmë se sundimtarë të Egjiptit atëbotë kanë qenë hykët, të cilët kanë qenë semitë dhe s'e përdornin termin "faraon". Përkundrazi, egjiptianët vendas emërtonin sundimtarët e tyre me këtë emër. Sundimtari i Egjiptit në kohën e Moisiut ishte një egjiptian vendas që kishte zëvendësuar hykët dhe që kishte filluar të shtypte fisin e Izraelit. Nëse Muhamedi paska kopjuar Biblën, pse nuk e kopjoi edhe këtë gabim historik? Pastaj, nga e mori këtë informatë kaq të saktë? Në atë kohë as që ekzistonte egjiptologjia. Njohuria për leximin e hieroglifëve kishte humbur qindra vite më parë dhe ishte e panjohur deri në zbulimin e Gurit të Rozetës 1000 vjet më vonë. Kjo e bën informatën e radhës edhe më interesante.

Kurani tregon historinë se si Moisiu shkoi te Faraoni dhe e ftoi atë të besojë në... në atë që po lexoni këtu. Faraoni filloi ta pyesë Moisiun për këtë Zot të padukshëm mbi qiej. Tani Faraoni mendonte se vetë ishte zot. Madje, ai mendonte se mund të komandonte perënditë me anë të magjisë. Kështu ai me arrogancë i thotë njërit prej njerëzve të tij:

“Faraoni tha: “Dhe Faraoni tha: “O Haman, ndërto më një kullë që t’i arrij rrugët, rrugët e qiellit e të shoh Zotin e Musait, sepse jam i bindur se ai (Musai) gënjen.” (Kurani; Kapitulli 40 - Falësi, versetet, 36-37)

Është thënë shumë për përmendjen e këtij farë Hamanit, ku disa kanë pretenduar se Muhamedi kopjoi ngjarje nga Bibla dhe pastaj i ngatërroi krejt. Njëfarë Hamani përmendet në Bibël në Librin e Estherit,

libër që konsiderohet të ketë autenticitet të dyshimtë, i cili e vendos këtë person në kohën e Persisë si shërbëtor në oborrin e Ahasueros. Megjithatë, nuk ka të dhëna të pavarura historike që tregojnë se ky person vërtet ka ekzistuar në Persi. Në fakt, studiuesit biblikë e kanë identifikuar Hamanin si perëndi elamite të Humanit, ose ndoshta hamajun persian, që do të thotë “ilustrues” dhe e kanë lidhur me emrin persian Ovanes.

Ne, megjithatë, ndryshe nga pretendimet tallëse të shumë polemizuesve të krishterë, kemi një Haman në Egjiptin e Lashtë, që i përshtatet plotësisht përshkrimet kuranor.

Dr. Maurice Bucaille ishte një nga njerëzit e parë që studioi emrin Haman nga pikëpamja egjiptologjike. Ai supozoi se, meqenëse Hamani është përmendur në Kuran gjatë

kohës së Moisiut në Egjipt, hapi më i duhur në këtë rast ishte konsultimi i një eksperti të gjuhës së vjetër egjiptiane, d.m.th. hieroglifëve, në lidhje me këtë emër. Bucaille rrëfen një diskutim interesant që pati me një egjiptolog të shquar francez:

"Në librin *Reflektime mbi Kuranin (Réflexions sur le Coran)*, kam përmendur rezultatin e një konsultimi që kam bërë nga 10 vjet më parë, gjë që më bëri të pyesja një specialist që njihnte edhe gjuhë arabe klasike. Një nga egjiptologët më të shquar francezë që përmbushte këto kushte ishte mjaft i mirë sa për t'iu përgjigjur pyetjes.

I tregova fjalën "Haman" që e kisha kopjuar saktësisht siç gjendet në Kuran dhe i thashë se ishte nxjerrë prej një fjalie të një dokumenti që daton në shekullin VII pas

Krishtit, fjali kjo e cila lidhej me dikë që kishte të bënte diçka me historinë e Egjiptit.

Ai më tha se, në atë rast do ta kërkonte këtë emër në hieroglifë, ndonëse s'besonte se ishte e mundur që një dokument i shekullit VII të kishte pasur një emër hieroglifik, - të panjohur deri në atë kohë, - pasi, në atë kohë, hieroglifët ishin harruar plotësisht.

Për të konfirmuar deduksionin e tij për emrin, ai më këshilloi të konsultoja librin *Dictionary of Personal Names of the New Kingdom (Fjalori i Emrave të Përveçëm të Mbretërisë së Re)* nga Ranke, ku mund të gjeja emrin e shkruar me hieroglifë, të cilin ma kishte shkruar tashmë, si dhe transliterimin në gjermanisht.

Zbulova gjithçka që eksperti kishte supozuar dhe, për më tepër, u shtanga kur lexova

profesionin e Hamanit: “Shefi i punëtorëve në guroret”, pikërisht ajo që mund të nxirret prej Kuranit, megjithëse fjalët e Faraonit tregojnë një mjeshtër ndërtimi.

Kur shkova përsëri tek eksperti me një fotokopje të faqes së fjalorit në lidhje me “Hamanin” dhe i tregova një nga faqet e Kuranit ku përmendej emri i tij, e ai mbeti pa fjalë.

Për më tepër, Ranke kishte vënë në dukje, si referencë, një libër të botuar në vitin 1906 nga egjiptologu Ualter Ureszinski. Ky i fundit ka përmendur se emri “Haman” është gdhendur në një stelë që mbahej në Muzeun Hof të Vjenës (Austri). Disa vjet më vonë, kur arrita të lexoj profesionin të shkruar me hieroglifë në stelë, vura re se përcaktori i ngjitur me emrin kishte

theksuar rëndësinë e marrëdhënies së afërt të Hamanit me Faraonin.

Eh pra, ky është “nivel i mahnitshëm informatash” që kam përmendur unë!

Prej nga e mori Muhamedi këtë informatë, nëse jo nga Zoti?

Ka ende.

Përfytyro botën 1400 vjet më parë dhe nivelin e njohurive shkencore atëbotë. Është e vërtetë se ka pasur mendimtarë dhe filozofë që kishin bërë disa zbulime të mahnitshme, siç është matja e përpiktë e perimetrit të tokës. Megjithatë, shumë gjëra i kanë kuptuar gabim. Mes tjerash, kishin edhe legjenda e mite të tepruara.

Kurani pretendon të jetë libër për të gjitha kohët, vendet dhe njerëzit. Andaj, kur ky libër përmend botën natyrore, nuk ka për

qëllim të sfidojë idetë e kufizuara të njerëzve për mënyrën se si funksionon natyra. Përkundrazi, qëllimi i tij kryesor është të motivojë dhe të inkurajojë njerëzit që të arrijnë të kuptojnë se pas botës fizike qëndron një fuqi dhe urtësi hyjnore. Sa më shumë që vlerësojmë fuqinë dhe mençurinë që qëndron pas çdo gjëje, aq më shumë duhet të na bëjë të dimë se kush është Krijuesi ynë, duke na shtyrë kështu të lavdërojmë dhe të adhurojmë vetëm Zotin. Qëllimi tjetër i Kuranit është të na bëjë të reflektojmë mbi kuptimet shpirtërore pas përkrahimeve të botës natyrore.

Përkrahimet kuranore të botës dhe universit janë mrekullisht të përjetshme. Fjalët e përdorura tërheqin lexuesit e kohës së lashtë, por po ashtu kanë kuptim mahnitës për lexuesit modernë sot. Arsyeja kryesore

pse përshkrimet kuranore janë të përjetshme është se ato nuk varen nga kuptimi ynë i kufizuar për funksionimin e gjërave. Përkundrazi, ato na inkurajojnë të kuptojmë se, - pavarësisht nga njohuritë tona shkencore gjithnjë në ndryshim, - gjithmonë ka një urtësi dhe fuqi pas krijimit. Kjo duhet të na shtyjë të kuptojmë se kjo fuqi dhe urtësi janë nga Krijuesi ynë.

Diçka tjetër që e bën Kuranin të përjetshëm është se ai arrin t'u drejtohet disa niveleve të ndryshme të të kuptuarit në të njëjtën kohë. Merr si shembull versetin e mëposhtëm:

“Allahu është Ai, i Cili krijoi natën dhe ditën, Diellin dhe Hënën; e të gjitha këto lundrojnë në gjithësi (jesbeḥūn). (Kurani; Kapitulli 21 - Profetët, ajeti 33)

Në kohën kur është shpallur ky verset (shekulli VII), fjala *jesbeḥūn* (noton ose lundron), e cila përdoret për të përshkruar lëvizjen e diellit dhe hënës, mund të konfirmohet me sy të lirë nga një arab i thjeshtë i shkretëtirës. Megjithatë, kjo fjalë ka kuptim edhe për ne sot, pasi mund të lidhet me gjetjet aktuale shkencore në lidhje me orbitat e planetëve në hapësirë.

Mustansir Mir, profesor i Studimeve Islame në Universitetin Shtetëror të Youngstoun, thotë si vijon:

“Fjala *jesbeḥūn* (noton ose lundron) kishte shumë kuptim për arabët e shekullit të shtatë që vëzhgonin fenomenet natyrore me sy të lirë dhe ka po aq kuptim për ne nën dritën e gjetjeve të sotme shkencore (domethënë mekanikës qiellore).”

Është shumë interesante se ajeti i mësipërm përmend se Dielli noton ose lundron në një orbitë. Kjo mund të adresojë pikëpamjen primitive të shekullit VII se Dielli rrotullohej rreth Tokës. Nga një vështrim më i afërt i gjuhës së përdorur në Kuran, mund të arrijmë në përfundimin se ai trajton gjithashtu pikëpamjen e saktë të shekullit 21 se Dielli ka orbitën e tij. Dielli, në fakt, rrotullohet rreth qendrës së Rrugës së Qumështit dhe, sipas shkencëtarëve, nevojiten 226 milionë vjet për ta përfunduar këtë rrotullim. Kjo është në përputhje me përshkrimin kuranor, sepse nuk ka asgjë në Kuran që aludon se lëvizja e Diellit bëhet rreth Tokës, gjë që do të ishte e pasaktë sipas të kuptuarit aktual shkencor. Disa ajete duken sigurisht më mbresëlënëse se disa të tjera kur shikohen

nga një këndvështrim modern, por, njëkohësisht, nuk janë në shpërputhje me disa nocione të kohës kur është shpallur Kurani. Një ajet i tillë përfshin përshkrimin e origjinës së universit, të referuar si "qiejt dhe Toka". "A nuk e dinë mohuesit se qiejt dhe Toka kanë qenë një e tërë? Pastaj Ne e ndamë dhe bëmë prej ujit çdo gjë të gjallë! Akoma nuk besojnë?!" (Kurani; Kapitulli 21 - Profetët, ajeti 30)

Kjo duket të jetë në përputhje me përshkrimin e origjinës së universit sipas së ashtuquajturës teoria e Big Bengut, që diskutuam në fillim të këtij libri.

Përveç tërheqjes së vëmendjes sonë te fuqia supreme e Krijuesit, Kurani duket se u bën jehonë ideve më të fundit rreth një universi në zgjerim.

"Ne e kemi ndërtuar qiellin me fuqinë Tonë dhe Ne e zgjerojmë atë." (Kurani; Kapitulli 51, ajeti 47)

Kurani na tërheq vëmendjen tek origjina modeste e njeriut, kur thotë: "E mandej, pikën e farës e bëmë droçkë gjaku (alekah). (Kurani; Kapitulli 23 - Besimtarët, ajeti 14)

Kurani përdor fjalën "alekah", që mund të nënkuptojë substancë të varur, shushunjë ose krimb, gjak të mpiksur, ose gjak në kuptim të përgjithshëm. Kjo fjalë përdoret për të përshkruar një fazë të zhvillimit të embrionit njerëzor.

Përshkrimi që i referohet embrionit si substancë e varur dhe gjak i mpiksur mund të shihej me sy të lirë, pasi mjekët e lashtë grekë dhe hebrenjtë e lashtë që i paraprinë shpalljes kuranore gjithashtu e

përshkruanin embrionin si substancë të varur dhe gjak të mpiksur. Pra, nga ky këndvështrim, ajeti kuranor pajtohet me një pikëpamje mbizotëruese të asaj kohe.

Megjithatë, fjala “alekah” i referohet edhe një krimbi ose një shushunje. Vlen të përmendet se embrioni, në fakt, duket si një krimb ose një shushunjë rreth ditëve 22-25 të zhvillimit të tij. Edhe pse embrioni në këtë fazë mund të shihet me sy të lirë, detaje të tilla nuk mund të vëzhgohen pa mikroskop. Meqë mikroskopi u zbulua në shekullin 15, kjo pamje e embrionit është zbuluar së paku 12 shekuj pas shpalljes së Kuranit.

Përveç kësaj, përshkrimi kuranor i embrionit gjithashtu mund t'i referohet perspektivës shpirtërore ose morale, e jo vetëm asaj shkencore. Kështu, embrioni mund të kuptohet se ai vepron si një

shushunjë. Me fjalë të tjera, ai vepron si parazit. Pra, ashtu si ngjitet shushunja pas bartësit të saj dhe fillon të thithë gjakun e saj, ngjashëm embrioni shter burimet e nënës duke thithur gjakun e saj. Ky përshkrim i fuqishëm na kujton se sa nevojtarë jemi në përgjithësi dhe sa shumë varemi nga nënat tona. Për pasojë, kjo duhet të na motivojë që ta trajtojmë nënën me respektin dhe mirësinë më të madhe.

Është interesante se ky krahasim midis shushunjës dhe embrionit është bërë edhe nga Lordi Robert Uinston, i cili është profesor i Shkencës dhe Shoqërisë dhe profesor emeritus i Fakultetit të Fertilitetit në Kolegjin Mbretëror.

“(Shushunja) merr gjithçka që i nevojitet për të jetuar duke thithur gjakun e diçkaje që mund t’i kapet, si për shembull mua. Ndërsa

thith gjakun tim, merr prej tij gjithçka që i nevojitet për të jetuar, pra, jeton nga unë me plot kuptimin e fjalës. Kështu, edhe shtatzënia karakterizohet me një raport të ngjashëm parazitar. Ndryshe nga shushunja, embrioni në zhvillim nuk thith gjakun e nënës, por merr vetëm lëndët e para që i nevojiten për t'u rritur. Pra, në parim, edhe shushunja, edhe embrioni, luftojnë për mbijetesë.”

Disave u ka bërë kaq shumë përshtypje saktësia e Kuranit në përshkrimin e zhvillimit të embrionit njerëzor, saqë ata menduan se do të mund të shërbente si një model për një sistem përshkrues më të thjeshtë dhe më të kuptueshëm. Keith Moore, profesor emeritus në Departamentin e Anatomisë të Fakultetit të Kirurgjisë në Universitetin e Torontos, që

ishite embriologu kryesor në botë, në lidhje me këto deklarata në Kuran dhe në hadithet e vërtetuara, tha:

“Deri në shekullin 19, asgjë nuk dihej për klasifikimin e fazave të zhvillimit njerëzor. Një sistem i klasifikimit të fazave të zhvillimit të embrionit u zhvillua rreth fundit të shekullit 19 bazuar në simbolet alfabetike. Gjatë shekullit 20 janë përdorur numrat për të përshkruar 23 faza të zhvillimit embrional. Ky sistem i numërimit të fazave nuk është i lehtë për t'u ndjekur dhe më i mirë se ky do të ishte një sistem bazuar në ndryshime morfologjike. Në vitet e fundit, studimi i Kuranit ka zbuluar një bazë tjetër për klasifikimin e fazave të zhvillimit të embrionit, e cila bazohet në veprime lehtësisht të kuptueshme dhe ndryshime në formë. Ai përdor termat që i

janë dërguar profetit Muhamed nga engjëlli Gabriel (Xhibril) dhe janë regjistruar në Kuran... Është e qartë për mua se këto deklarata medoemos i kanë ardhur Muhamedit nga Zoti, sepse pothuajse gjithë kjo njohuri u zbulua shumë shekuj më vonë. Kjo më vërteton se Muhamedi duhet të ketë qenë i Dërguari i Zotit.”

Deklaratat në Kuran në lidhje me botën natyrore u drejtohen niveleve të ndryshme të të kuptuarit me një sërë kuptimesh të mundshme që arrijnë të prekin audienca të ndryshme, qoftë të shekullit 7, qoftë të shekullit 21. Ky është një tipar vërtet i jashtëzakonshëm i Kuranit, i cili patjetër duhet ta shtyjë njeriun të mendojë për autorësinë e këtij libri. Ka mundësi, sigurisht, që disa gjëra të duken sikur nuk

përputhen me kuptimin tonë aktual shkencor.

Megjithatë, shkenca vazhdimisht ndryshon pikëpamjet e saj për gjërat, sepse kështu funksionon shkenca, pra duke përditësuar përfundimet e saj kur mbledh të dhëna të reja. Shkencëtarët nuk arrijnë kurrë të kenë një numër të pafund vëzhgimesh. Prandaj, gjithmonë do të ekzistojë mundësia e një vëzhgimi të ri që mund të jetë në kundërshtim me përfundimet paraprake. Shkenca mund të ndryshojë, madje edhe teoritë që dikur dukej se ishin funksionale. Kjo tregon se vetëm për shkak se diçka funksionon nuk do të thotë se është absolutisht e vërtetë. Historia e shkencës është përplot shembuj që e vërtetojnë këtë pikë.

Megjithatë, nuk ka deklarata në Kuran në lidhje me botën natyrore që do të mbesin gjithmonë të pakuptueshme nga këndvështrimi shkencor, sepse nivele të reja të njohurive dhe kuptimeve janë gjithmonë të hapura për ne. Pra, shkenca e sotme nuk mund t'ia mbyllë derën Kuranit, sepse shpejt mund të mbetet shkencë e djeshme.

Megjithatë, nuk duhet të harrojmë se Kurani nuk është libër i shkencës, por libër i shenjave. Të menduarit thellë mbi këto shenja ndihmon një person të arsyeshëm të arrijë në përfundimin se natyra dhe qëllimi i përjetshëm i këtij libri është përtej mundësive të një njeriu të pashkolluar që ka jetuar 1400 vjet më parë. Përkundrazi, ai buron nga Krijuesi që njeh të kaluarën dhe të tashmen. Libri dëshiron që ne të lidhemi

me Krijuesin tonë duke na ndihmuar të kuptojmë se gjithçka që vëzhgojmë ekziston për një qëllim të thellë dhe fisnik, që është ta adhurojmë vetëm Atë.

Kapitulli 7

MËSIMET E LIBRIT

Atëherë, cilat janë mësimet bazë të Kuranit?

Mirë, gjëja e parë që duhet pranuar është se ekziston një Zot, i Cili është unik dhe ndryshe nga çdo gjë tjetër dhe se asgjë nuk është si Zoti. Zoti është Një dhe i Vetëm, i Cili nuk ka ortakë e rivalë dhe ne duhet t'i lutemi dhe të adhurojmë vetëm Krijuesin.

Tani, sa i përket asaj se si të falesh, ta adhurosh Krijuesin dhe të udhëhiqesh nga dija e Tij, këtu na duhet Muhamedi. Kurani na mëson se të gjithë profetët dhe të dërguarit e Zotit te njerëzit kanë qenë vetë njerëz. Kjo, se ata, jo vetëm që kanë dhënë një mesazh, por jeta e tyre është gjithashtu shembull praktik si të ndiqet dhe të zbatohet ai mesazh. Është shumë e

logjikshme. Pra, nëse është ndonjë njeri që mund ta jetësojë këtë mesazh, atëherë, të paktën teorikisht, edhe ne të tjerët mundemi! Nëse i dërguari te ne do të ishte engjëll, atëherë të gjithë do të arsyetoheshim se nuk mund të ishim si engjëlli, pasi është e lehtë për të të jetë, si të themi, engjëllor!

Jeta, - na thotë Kurani, - është një provë. Prandaj ka vuajtje dhe gëzim, shëndet dhe sëmundje, pasuri e varfëri, mirësi dhe ligësi, natë e ditë, errësirë dhe dritë. Të kundërtat i japin kuptim njëra-tjetrës. Si mund ta vlerësojmë të mirën pa qenë e keqja? Sa shpesh na ndodh që ta vlerësojmë shëndetin vetëm pasi të sëmuremi? Testi është të njohim realitetin e vetvetes. A do ta pranojmë të vërtetën apo do të ndjekim dëshirat tona? A do t'i bindemi Krijuesit apo

do të rebelohemi ndaj Tij? Zoti na ka dhënë udhëzim dhe vullnet të lirë. Andaj, duhet ta përdorim inteligjencën tonë për të kuptuar dhe ndjekur atë udhëzim. Nëse bëjmë gabime, siç është e pashmangshme, meqë jemi njerëz, duhet të dimë se, përderisa vazhdojmë të kërkojmë udhëzimin e Krijuesit, të kërkojmë falje dhe të bëjmë çmos për t'u përmirësuar, Krijuesi do të vazhdojë të na falë. Në fakt, njohja e kufizimeve tona dhe njohja e madhësisë së Zotit është vetë thelbi i Islamit. Kjo është arsyeja pse njerëzit duhet t'i nënshtrohen e t'i dorëzohen Zotit dhe ky është pikërisht kuptimi i Islamit.

Arsyeja e ekzistencës sonë, qëllimi kryesor i mendjeve tona komplekse dhe dhuntia e arsyes është të kuptojmë dhe të përpiqemi të bëjmë gjithçka ashtu siç e kënaq

Krijuesin. Ne dimë si ta bëjmë këtë nëpërmjet udhëzimeve që na janë dhënë. Për të na ndihmuar të jetojmë në mënyrë më efektive dhe të jemi konstantë në këtë, Krijuesi e ka bërë komponent thelbësor të kësaj mënyre të jetesës ofrimin e akteve të rregullta të adhurimit në jetën tonë. Nuk është se Zoti ka nevojë për këtë, aspak! Zoti nuk ka nevojë dhe është plotësisht i Vetëmjaftueshëm. Përkundrazi, ne jemi krijuar me atë nevojë. Sikundërqë trupat tanë kanë nevojë për ushqim, mendjet tona dhe shpirtrat tanë janë krijuar për t'u ushqyer me kujtimin dhe adhurimin e Zotit. Andaj, vepra më e rëndësishme që duhet të bëjë një musliman (ai që ndjek Islamin) është të falet në mënyrë të veçantë dhe në kohë të veçanta gjatë ditës dhe natës. Është fjala për pesë lutje rituale të përditshme ose

namaze. Falja e këtyre namazeve të rregullta rituale me singëritet e kuptim është çelësi i përmirësimit tonë. Kur bëhet siç duhet, është një ritual që ndryshon jetën.

Një komponent tjetër thelbësor është dhënia e lëmoshës për të ndihmuar të varfrit dhe nevojtarët. Një nga komponentët më të rëndësishëm të një jete që kënaq Zotin është mirësia dhe ndihma ndaj të tjerëve.

Natyrisht, kjo lloj jete kërkon disiplinë, vetëkontroll e durim dhe për këtë arsye agjërimi ka qenë gjithmonë një komponent i jetës fetare dhe kjo vlen edhe për Islamin. Çdo vit ka një muaj të quajtur Ramazan, kur njeriu duhet të lërë ushqimin, pijen dhe marrëdhëniet intime nga agimi deri në perëndim të diellit. Gjithashtu është e

rëndësishme që të përpiqemi të largohemi nga e keqja në të folur e në veprime, pasi ky është thelbi i agjërimit.

Ta thuash të vërtetën, të mos gënjesh, të mbash premtimet, të përmbushësh amanetet, të jesh gjithmonë i drejtë, qoftë dhe kundër familjes ose vetvetes, të gjitha këto janë karakteristika thelbësore të besimtarit të vërtetë.

Të respektosh prindërit dhe të jesh i sjellshëm me ta, veçanërisht në pleqëri, të jesh i mirë me të afërmit e të inkurajosh të mirën dhe të dekurajosh të keqen janë po ashtu virtyte thelbësore.

Këto përbëjnë bazat e Islamit dhe të të qenit musliman.

Jeta është e shkurtër dhe shpejt, shumë shpejt do të vdesim të gjithë, por vdekja nuk është fundi.

Kurani na mëson se ka një ditë gjykimi kur Zoti do të na mbledhë së bashku dhe ne do të japim llogari për gjithçka që kemi bërë. Ne do të dimë për çdo të mirë e të keqe që kemi bërë, qoftë dhe sa pesha e atomit.

Ata që refuzuan të vërtetën, që zgjodhën të rebelohen, i pret një dënim i tmerrshëm. Vetë e kanë bërë këtë zgjedhje. E vërteta ishte e qartë për ta, por ata preferuan ta shpërfillnin dhe kështu i pret një fat i tmerrshëm, zjarri i Ferrit, ku njerëzit do të piqen e do të digjen dhe nuk do të vdesin, por do të vazhdojnë të vuajnë përjetësisht.

Ata që ishin të mirë dhe bënë një jetë të bindur ndaj Zotit, do të jetojnë

përgjithmonë në gëzim e lumturi absolute në parajsë. Nuk do të ketë urrejtje, zemërim e xhelozë, por paqe dhe lumturi fizike e shpirtërore. Sa vendbanim i bukur që është ai!

Në të vërtetë, pikërisht te kjo na fton Krijuesi, pra, te Parajsa e Tij. Të ndjekësh Islamin nuk nënkupton se nuk do të ketë më prova ose vështirësi në jetë. Ç'është e vërteta, Krijuesi na tregon se nuk do të lihem të themi se kemi besuar e të mos sprovohemi. Udhëzimi i Zotit na mëson si t'i përballojmë ato prova, kështu që vështirësia kthehet në lehtësi, hutimi në qartësi, dhimbja në kënaqësi dhe trishtimi në gëzim.

Njohja dhe ndjekja e kësaj sjell paqe të vërtetë në zemër. Në këtë kuptim, Islami vërtet sjell paqe. Jo paqe në kuptimin e

moszhvillimit të luftës, por paqe që është e thellë dhe kuptimplotë.

Kapitulli 8

PËRFUNDIMI I UDHËTIMIT

Ja ku e kemi.

I jemi afruar fundit të udhëtimit tonë dhe destinacioni duket në horizont. Vetëm një gjë ka mbetur për ta bërë!

Është koha ta hapësh derën dhe të lësh mesazhin e vërtetë nga Krijuesi që të udhëheqë jetën tënde.

Po, mund të të duket paksa e çuditshme dhe obligimet që pasojnë nuk janë diçka me të cilat je mësuar. Ndoshta je duke menduar me vete se çfarë do të thonë familja dhe miqtë e tu! E po, s'është patjetër të thuash diçka. Thjesht mund t'ua dhurosh këtë libër e t'u thuash ta lexojnë!

Siç thashë më parë, nuk është vështirë të kuptosh se sa e arsyeshme është gjithë kjo. Më e vështirë është të veprosh në bazë të saj! Në fakt, nëse flasim hapur dhe sinqerisht, as kjo nuk është aq e vështirë!

Thjesht fillo me vendimin e sinqertë se po e bën këtë se Krijuesi yt e dëshiron këtë prej teje! Mirë, e pse nuk provon të kërkosh ndihmë atëherë? Po! Thjesht lute Krijuesin e gjithçkaje, vetëm Atë, jo nëpërmjet dikujt ose diçkaje, por thjesht drejtoju Atij me sinqeritet nga zemra që të të udhëzojë dhe të të ndihmojë të bësh gjënë e duhur.

Mirë pra! Si ndihesh tani?

Atëherë, nëse ndihesh ashtu si po ma merr mendja, vetëm ndiq hapat në vijim.

Thjesht thuaj: “Unë dëshmoj se askush përveç Allahut nuk meriton të adhurohet

dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij (kjo të bën musliman) ose në arabisht “Esh hedu en la ilahe il-lallah ve eshedu enne Muhameden resulullah!” Pas kësaj duhet të fillosh të falësh pesë namazet që një musliman duhet t’i falë çdo ditë.

Tash për tash, kjo duhet të jetë brenga jote kryesore.

Paqja dhe bekimi i Zotit qofshin gjithmonë me ty.

Titulli i origjinalit:
The Man in the Red Underpants

Autor:
A.R. Green

Përktheu:
Kushtrim Berisha

Redaktor gjuhësor:
Jeton Koqinaj

Redaktor profesional:
Jusuf Kastrati

Kopertina:
Fatlum Zeka

Botoi:
Instituti Germa